VENDIM
Nr.14, datë 24.5 2006

PËR MIRATIMIN E BLERJES SË 10% TË AKSIONEVE TË SHOQËRISË SË SIGURIMEVE ALBSIG SHA NGA Z.FAIK BRUCI

Në mbështetje të neneve 55 dhe 56 dhe të pikës 2 të nenit 57 të ligjit nr.9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimeve, risigurimeve dhe ndërmjetësimin në sigurime dhe risigurime" dhe shkronjës "f" të nenit 6 dhe të shkronjës "k" të pikës 2 të nenit 14 të ligjit nr. 9268, datë 29.07.2004 "Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikëqyrës së Sigurimeve", Këshilli i Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve

VENDOSI:

1. Të miratojë pjesëmarrjen influencuese të aksionarit të shoqërisë së sigurimit "Albsig" sh.a. nëpërmjet blerjes së aksioneve të reja të emetuara si më poshtë:

a) Z. Faik Bruci aksionar me pjesëmarrje prej 10 % (dhjetë për qind) të aksioneve në shoqërinë e sigurimeve Albsig sh.a.

2. Autoriteti Mbikëqyres i Sigurimeve rezervon të drejtën e revokimit të miratimit të pikës 1 të këtij vendimi në rast se më vonë do të rezultojë:

a) është dhënë mbi bazën e informacionit të pasaktë ose të rremë;

b) rrezikon veprimtarinë e shoqërisë së sigurimit sipas parashikimeve te kreut VI të ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004.

Ky vendim hyn në fuqi 24.5.2006.

ANËTARI I KËSHILLIT TË AUTORITETIT
MBIKËQYRËS TË SIGURIMEVE
Shpëtim Shehu